

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenet 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Autoritetit Kontraktues – KOMUNA E ISTOGUT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **633-26-1476-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **“Sinjalizimi horizontal dhe vertikal (633-026-012-211)”**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

“TSR” Sh.P.K.

Rr. “Fehmi Lladrovci” nr. 99

Fushë Kosovë

12000

+383 (0)44 34 13 68

Marksim Malsijaj, Drejtor

info@tsr-ks.com

01.06.2026

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit

te prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

B05 Njoftimi për Kontratë & Dosja e Tenderit – 19.03.2026

B58 Njoftimi mbi Vendimin – 15.05.2026

Kërkesa për rishqyrtim – 20.05.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmblylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 59 par. 4 i LPP lidhur me nenin 61 të LPP lidhur me nenin 41 të RRPP.

** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me datë 15.05.2026 AK ka publikuar njoftimin mbi vendimin përmes të cilit e ka rekomanduar për kontratë OE “Traffiks VA Sh.P.K.”. Në rastin konkret të ky OE nuk ka arritur që të përmbushë kërkesat e DT. Ngjashëm nuk kanë arritur që të përmbushin kërkesat e DT as OE “Lindi Markings shpk”, dhe as OE “NSH Liri”. Prandaj në vendimin e AK është dashur që të njëjtët të eliminohen si të papërgjegjshëm.

Pretendimi nr. 1 – OE “Traffiks VA” Sh.P.K. ka ofertuar me çmime jonormalisht të ulëta. Çmimi me të cilin ka ofertuar ky OE është 84.41 euro. Oferta e dytë më e lirë është 96.90 euro dhe si e tillë është dukshëm më e shtrenjtë sesa 10% sesa oferta e tenderuesit të rekomanduar. Përndryshe në këtë aktivitet janë dorëzuar 6 oferta (sipas AK të gjitha të përgjegjshme). Mesatarja e çmimit të ofertave të përgjegjshme është 114.64 euro që nënkupton se oferta e tenderuesit të rekomanduar është rreth 30% më e lirë sesa mesatarja e çmimeve nga ofertat e përgjegjshme.

Përmes nenit 41.3 dhe 41.4. të RRPP është përcaktuar si vijon:

41.3 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
- ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
- iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

41.4 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 41.3 të kësaj rregullore, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tille dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së.

Ndërsa përmes nenit 41.5 të RRPP përcaktohet si vijon: *“Kur një tender konsiderohet si jo normalisht i ulët në pajtim me Nenin 61 të LPP dhe paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një tender i tille nuk mund të refuzohet pa hetimin dhe shqyrtimin e elementeve të rëndësishme që shkaktojnë tenderin veçanërisht të ulët”*.

Në rastin konkret AK nuk ka kërkuar fare sqarime për shkak të çmimit jonormalisht të ulët, përkundrazi këtë OE e ka rekomanduar për kontratë.

Pretendimi nr. 2 – tenderuesi i rekomanduar ka ofruar çmime jonormalisht të ulëta në pozicionet 1.5, 1.6, 1.7, 1.8, 1.9, 2.4 dhe 2.5. Për të demonstruar këtë fakt mund të marrim si shembull pozicionin 1.9 me çmim prej 1 euro për *“hapjen e zgavrave dhe betonimi i fortë (i qëndrueshëm) i shtyllave me thellësi min. 0.50x0.50 (në bazën e betonimit të parashihet edhe vendosja e një fije armature 10mm gjatësi 40 cm sipas nevojës heqja e kubëzave dhe vendosja e tyre në gjendjen paraprake deri te shtylla e betonuar)”*. Pra vetëm hapja e zgavrave është vështirë të mbulohet me 1 euro. Paga minimale në Kosovë nga 01.07.2026 është 500 euro që nënkupton se ora minimalisht paguhet rreth 3,20 euro. Nëse procedura për hapjen e një zgavre të tillë do të zgjasë vetëm 15 minuta, atëherë kosto e punës së dorës është më e shtrenjtë sesa çmimi prej 1 euro me të cilin ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar. Shtu kësaj faktin që në pozicion kërkohet betonim i fortë, pastaj një fije e armaturës, punimi me kubëza dhe veprime të tjera.. Pra nga të gjitha këndvështrimet e mundshme, çmimi për këtë pozicion është jonormalisht i ulët. Vetëm për këtë fakt AK është dashur të eliminonte këtë ofertë si të papërgjegjshme. Përndryshe ekzistojnë edhe shumë pozicione tjera me çmime jonormalisht të ulëta. Si shembull të tjerë mund të marrim pozicionin 1.5. me çmim prej 2.00 euro për *“Furnizimi dhe vendosja e shenjave të rrezikut me dimensione (gjerësi b= 60 cm), me rreth alumini 2 mm trashësi (ALFOR) me foli 3M, prej materialeve ISO Standarte”*. Duke marrë parasysh që kërkohet alumin, atëherë duhet sqaruar se një copë nga ky produkt alumini me dimensione të kërkuara peshon 3.7 kg. Në rastin konkret çmimi i mbeturinave

(skrapit) sillet për 1 kilogram në tregun e Kosovës rreth $1 \times 1.39 = 5.14$ euro me çmim mbeturine. Mirëpo ky produkt nuk prodhohet në Kosovë por duhet të blehet dhe importohet si produkt i gatshëm dhe atë i dorës së parë me masa apo dimensione të caktuara dhe njëkohësisht i ngjyrosur me ngjyrë të hirit mbrapa. Çmimi aktual i tregut është minimumi rreth 3.5 euro për kg. Nëse i shtojmë edhe folien 3M e cila kërkohet me paramasë, atëherë vetëm çmimi i blerjes për m² është minimumi rreth 8.00 euro për m². Pra në total çmimi për të kompletuar këtë pozicion është nga 18 deri në 24 euro për m² (prej të cilave rreth 4.6 euro kushton vetëm folia 3M). AK mund të verifikoj këto fakte lehtësisht qoftë përmes DUD doganor (sepse alumini dhe folia 3M importohen) apo krahasimin e çmimeve të tregut.

Ngjashëm vlen edhe për poz. 1.6, 1.7, 1.9. Po ashtu edhe për poz. 2.4 “Furnizimi dhe vendosja e pasqyrës së trafikut të formës rrethore ose drejtkëndëshe (dimensione Ø 60 cm, ose 60cmx60 cm) me një çmim qesharak prej 5.00 euro ku dihet se çmimi blerës në treg është rreth 48.00 euro. Po ashtu edhe ky është një produkt që importohet dhe shumë lehtë AK ka mund të kerkoj si dëshmi DUD doganor dhe të krahasoj çmimet e importit. Pastaj kemi poz. 2.5 me çmim prej 0.50 euro për “*rregullimi, drejtimi apo përforcimi i shenjave të dëmtuara në vendin ekzistues (furnizimi sipas nevojës i lidhëseve, bulonit, dados, etj)*”. Nëse marrim parasysh vetëm pagën minimale në Kosovë prej 500 euro kjo nënkupton që një orë pune minimalisht paguhet 3.2euro. Prandaj çmimet prej 50 cent apo 80 cent janë realisht qesharake dhe nuk duhet të ketë asnjë dilemë që këto çmime nuk e mbulojnë as fuqinë punëtore. Shtu kësaj faktin që këto punë duhet të involvohen edhe inxhinjeret për verifikimin e terrenit me paga të larta dhe punëtorët e thjeshtë fizik me pagë minimale. Përndryshe puna nuk duhet të realizohet pa materialin e kërkuar sipas paramasës. as te poz1.5, 1.6, 1.7, 1.8, 1.9, 2.4 dhe 2.5.

Pra nga të gjitha këndvështrimet e mundshme, çmimi për pozicionet janë 1.5, 1.6, 1.7, 1.8, 1.9, , 2.4 dhe 2.5. jonormalisht të ulëta (dmth ky OE ka 7 poz. apo rreth 35% e ofertës me çmime jonormalisht të ulëta dhe dukshëm nën çmimin e tregut).

Sa i përket çmimeve të tilla jonormalisht të ulëta pikërisht në fushën e sinjalizimit ekzistojnë disa vendime të OSHP. Njëri prej tyre është vendimi OSHP: 2025/1137. Andaj kërkojmë nga AK që të reflektoj të eliminoj të gjithë OE me çmime jonormalisht të ulët për shkak se me këto çmime nuk mund të realizoj fare kontratën.

Pretendimi nr. 3 – Te OE “Traffiks VA” vendimi për caktimin e udhëheqësit të punishtes, titulli i aktivitetit të prokurimit është shënuar gabim. Kjo krijon paqartësi se cilit aktivitet të prokurimit i referohet ky vendim prandaj nuk duhet të merret parasysh fare nga AK.

VENDIM

PËR CAKTIMIN E UDHËHEQËSIT TË VEND-PUNISHTES

“TRAFFIKS VA” sh.p.k. adresa: Rr “Radovan Zogoviq” Nr.27, Prishtinë, me NUI. 811582635,
përfaqësuar nga z. VISAR MURIQI – Drejtor

Ne, kompania Traffiks va sh.p.k. marrim vendim për caktimin e Udhëheqësit të Vend-Punishtes
z. AFRIM BULLUTI - Inxhinier i diplomuar – Komunikacion

KOMUNA E ISTOGUT

Titulli i tenderit: **Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal në Komunën e Istogut**

Numri i prokurimit: 633-26-1476-2-1-1

Pretendimi nr. 4– OE “Lindi Markings shpk” ka ofruar çmime jonormalisht të ulëta në pozicionet 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.9, 2.4 ,3.1, 3.2, 3.3, 3.4. Njëkohësisht sa i përket poz. 3.1, 3.2, 3.3,3.4 janë ofruar çmime prej vetëm 5.00 euro për m2, duke e ditur se për 1m2 ka shpenzime minimum 4 kg ndërsa kilogrami me çmim blerës varion nga 1,80 deri 2.20 pa shpenzime transporti dhe pa dogane dhe pa TVSH. Pra minimum 8 euro për m2 kushton vetëm materiali për të blerë pa i përfshirë edhe shpenzimet tjera sikurse fuqinë punëtore, makineritë, derivatet etj. Ngjashëm vlen edhe për pozicionet tjera 3.1,3.2, 3.3, 3.4 me çmime shumë të ulëta prej 5,00 për m2. Ndërsa sa i përket çmimeve jonormalisht të ulëta te 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.9, 2.4, vlejné absolut të gjitha sqarimet që janë dhënë te pretendimet më herët sa i përket tenderuesit të rekomanduar për kontratë.

Pra nga të gjitha këndvështrimet e mundshme, çmimi për pozicionet janë 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.9,2;4.3.1,3.2, 3,3,3.4. jonormalisht të ulëta.

Pretendimi nr. 5 – OE “NSH Liriu” ka ofruar çmime jonormalisht të ulëta në pozicionet 1.4, 1.5,1.6,1.7 2.5, 3.1, 3.2. Për të demonstruar këtë fakt vlejné absolut të gjitha sqarimet që janë dhënë te pretendimet më herët sa i përket tenderuesit të rekomanduar për kontratë. Njëkohësisht sa i përket poz. 3.1, 3.2, 3.3,3.4 janë ofruar çmime prej vetëm 5.00 euro për m2, duke e ditur se për 1m2 ka shpenzime minimum 4 kg ndërsa kilogrami me çmim blerës varion nga 1,80 deri 2.20 pa shpenzime transporti dhe pa dogane dhe pa TVSH. Pra minimum 8 euro për m2 kushton vetëm materiali për të blerë pa i përfshirë edhe shpenzimet tjera sikurse fuqinë punëtore, makineritë, derivatet etj. Ndërsa paradoksalisht ky OE ofron për poz. 3.1 dhe 3.2 me çmime qesharake prej vetëm 2,00 për metër katror.

Pretendimi nr. 6 – OE “NSH Liriu” e ka plotësuar gabimisht deklaratën nën betim për faktin që në fjalinë e parë të tekstit të deklaratës nuk e ka shënuar fare emrin e OE që e dorëzon këtë deklaratë (pra nuk janë plotësuar të gjitha rubrikat e deklaratës). Deklarata nën betim përbën kusht administrativ për të cilin OE duhet të eliminohet pa u shqyrtuar më tutje oferta.

Aneksi 2. DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [operatorin ekonomik që paraqitet] deklaroj nën betim se jam përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklaratë që përmban informata përmbytëse të gabueshme ose mashtruese.

Pretendimi nr. 8 – OE “NSH Liriu” nuk ka dorëzuar vendim për caktimin e udhëheqësit të punishtes por ka dorëzuar një deklaratë ku nuk figuron as numri i prokurimit dhe as emri i Autoritetit Kontraktues. Pra nuk dihet se kjo deklaratë për cilin AK është përpiluar dhe parashtruar si dhe për cilin aktivitet të prokurimit (me cilin numër) dedikohet.

Titulli i dokumentit:	Deklaratë
Data:	09.04.2026
Referencë:	R
Për:	Zyra e Prokurimit
CC:	Administrata e Ndërmarrjes
Nga:	Selman Kolgeci BI - NSH Liriu
Lënda:	Vendim

Për përmbushjen e kërkesave të specifikuara në dosjen e tenderit nga Autoriteti Kontraktues (më tutje AK) –

TITULLI: SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL (633-026-012-211)
përkatësisht për përmbushjen e kërkesës 9.1 dhe 9.2 , kompania jone ka vendosur qe per udheheqes i punishtes ta emroj Korab Elshani

NSH Liriu



Nga sa u tha më sipër propozojmë që Paneli Shqyrtues të merr këtë:

VENDIM

MIRATOHET si e bazuar ankesa ashtu që aktiviteti i prokurimit kthehet në **RIVLERËSIM**.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Do të precizohen.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*

- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-së, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.